



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSA" VLORE

VENDIM
Nr.19, Dt. 25.09.2007

Per miratim te kerkeses per leje, per perdorim te rezerves uJOR "Pus-Shpimi-Selenica 1", subjektit "Neli 98" sh.p.k. Selenice.

Ne zbatim te kerkesave te Ligjit Nr.8093 Dt.21/03/1996 "Per Rezervat Ujore" te percaktuara ne nenet 8-pika 1, neni 14-pika 1-shkronja Dh, neni 18, si dhe vendimi nr.1, dt.07.06.2007 te K.K.U-se, duke u bazuar edhe ne te dhenat e studimit dhe lejen per Pus-Shpimi dhene nga K.B.U "Vjose", me vendimin nr.6, dt. 06.08.2007, K.B.U "Vjose":

VENDOSI

1. Te miratoj kerkesen per leje per perdorim te nje pjese te burimit uJOR "Pus-Shpimi-Selenica 1", subjektit "Neli 98" sh.p.k. Selenice.
Ne vendin me koordinata:
X = 44 89 770 Y = 43 84 526 Z = 65m
2. Sasia e ujit qe jepet ne perdorim do te jete 2 l/sek.
3. Leja ka afat 5 vjecar deri me dt. 25.09.2012
4. Ngarkohet A.U.B "Vjose" Vlore, per zbatimin e ketij vendimi.
5. Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B VJOSA
Vezir METAJ



KRYETAR I K.B.U-se
Znj. Dorothe KONOMI

